

Fjalim i deputetes Ermonela Felaj

13.07.2023

– Faleminderit, zonja Kryetare!

Nuk e mora rastësisht këtë fjalë, por pikërisht sepse raportohej nga Autoriteti i Dosjeve ose Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Në fakt, ne, në këtë parlament, kemi lënë diçka përgjysmë që nga viti i shkuar, gjë e cila u vu në dukje edhe në formën e një sugjerimi nga ana e kryetares së Autoritetit. Po, në fund të vitit të shkuar, ne miratuam disa ndryshime shumë të rëndësishme në ligjin për autoritetin e dosjeve, që ka për detyrë të informojë publikun mbi ish-të kaluarën e regjimit komunist, në fakt, i duheshin dhënë mjetet dhe instrumentet ligjore në duar për të bërë të mundur ushtrimin e kësaj detyre dhe për të mos u ndarë me të njëjtat rezultate, siç më herët janë ndarë të ashtuquajturit komisione “Mezini” dhe “Bezhani”.

E dini se sa ka qenë bilanci i dosjeve së dy komisioneve të ngritura nga politika e 30 vjetëve? Përfundoi në 6 kuti nga komisioni “Mezini” dhe 3 kuti nga komisioni “Bezhani”, sepse kaq punuan. Politika e 30 vjetëve, ajo politika që flet gjithë ditën për moral, ajo politika që të drejton gishtin pa vënë një herë veten përballë pasqyrës, ajo politikë, në fakt, çoi në këtë bilanc, sepse i instrumentalizoi ato komisione, instrumentalizoi ligjin duke lejuar që ish-bashkëpunëtorët e ish-Sigurimit të Shtetit, hierarkë të armës më të fortë që kishte regjimi komunist, të depërtonin dhe të vijonin të dominonin dhe të dominojnë edhe sot në jetën politike dhe shoqërore të këtij vendi.

E pra, në fund të dhjetorit 2022, ne kemi premtuar se nuk do ta linim me kaq ndërhyrjen në ligjin për Autoritetin e Dosjeve, por do të vijonim më tej, që “gjuetia e shtrigave” që këtu ndodh rëndom, që njerëzve u vihet gishti dhe pastaj u kërkohet ta provojnë a janë kështu apo nuk janë, të mos ndodhë.

Po kthehem te neni 30 i ligjit. Ky nen i ligjit të Autoritetit të Dosjeve, kjo dispozitë për të cilën sapo foli kryetarja e Autoritetit, ku shprehu shqetësimin që zyrtarët e niveleve lokale, po, në fakt, të gjithë zyrtarët, nuk vijnë që të marrin clearing nga Autoriteti i Dosjeve, sigurisht që nuk do të vijnë dhe nuk ka për të ndodhur asnjëherë, sa kohë që kjo gjë të jetë diskrecionale, sepse duhet ta bëjmë me detyrim.

E pra, në nenin 30 të ligjit, thuhet: “Të gjithë ata që kanë qenë anëtarë ose kandidatë të Byrosë Politike, anëtarë të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, anëtarë të Presidiumit të Kuvendit Popullor, kryetarë të Gjykatës së Lartë, prokurorë të Përgjithshëm, kryetarë të Hetuesisë së Përgjithshme, anëtarë të Këshillit të Ministrave, kryetar të degëve të Punëve të Brendshme, anëtarë të Komisionit Qendror të Dëbim Internimeve, hetues, prokurorë, gjyqtarë në procese të posaçme politike, dëshmitarë të akuzës në këto procese apo punonjës të nivelit të lartë të ish-Sigurimit të Shtetit, bashkëpunëtorët e ish-Sigurimit të Shtetit, duke përfshirë këtu edhe

denoncuesit, edhe akuzatorët...”, pra, të gjithë këta që regjimi i përdori për të nëpërkëmbur jetë njerëzish, nuk mund të jenë, nuk duhet të jenë dhe nuk duhet të bëjnë punën, fjala vjen, të Presidentit të Republikës, të anëtares së Këshillit të

Ministrave, të zëvendësministrave, të funksionarëve politikë, anëtarë të trupës së nivelit të lartë drejtues në administratën shtetërore dhe pozicione të barasvlershme me to, anëtarë të organeve të sistemit të drejtësisë, nuk mund të jenë anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, nuk mund të jenë funksionarë të Forcave të Armatosura të Shtabit të Përgjithshëm, të Gardës së Republikës, nuk mund të jenë ata që mund të mbajnë gradën “Gjeneral” apo “Kolonel”, nuk mund të jenë prefektë, por nuk mund të jenë as në shërbimet informative të vendit, nuk mund të jenë as drejtues policie në nivel qarku dhe komisariati, nuk mund të jenë drejtues, nuk mund të jenë në përfaqësitë tona diplomatike, nuk mund të jenë në Bankën e Shqipërisë, nuk mund të jenë në Akademinë e Shkencave, nuk mund të jenë në Radio-Televizionin Publik, nuk mund të jenë në Agjencinë Telegrafike Shqiptare. Çdokush që emërohet, çdokush që zgjidhet, çdokush që merr një post zyrtari për të influencuar në jetën shoqërore në këtë vend, sigurisht, kur më herët ka pasur këto rekorde, nuk duhet të jetë në këto detyra, e, nëse është, duhet t’i ndërpritet ky lloj mandati dhe duhet të shkarkohet.

Këtë ka propozuar Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste të adresohet si ndryshim në ligjin për dekriminalizimin me vetëm 4 nene, dhe ne shlyejmë atë që ka bërë gabim për 30 vjet gjithë politika e mbrapshtë në këtë vend, duke larguar një herë e përgjithmonë jo thjesht origjinalët e ish-Sigurimit të Shtetit, kjo patjetër që është një shqetësim i madh mbarëshoqëror, por të largojmë edhe kopjet, se për sa kohë do të jetë në qarkullim origjinali, ne do të kemi këtu, do të kemi kudo, edhe kopjet. Kopjet janë ato që vijnë të flasin e të thonë: “hajdut”, “gjobaxhi”, pa pikën e cipës.

Kopjet janë asgjë më shumë. Këtë bënte regjimi, të vinte gishtin dhe pastaj të ndërtonte faktin.

Po këta njerëz, që e kanë kaq të lehtë t’i thonë dikujt që e kanë përballë, që e kanë kundërshtar, a përballen dot me ligjin dhe të shkojnë të provojnë këto shpifje kaq të ulëta të tyre?! A kanë cipë këta njerëz kur merren me familjarët, kur merren me bashkëshortët, kur merren me motrat, me vëllezërit?! Në këtë vend është bërë që të kesh motër, të kesh vëlla, të kesh burrë, të jesh njeri i ndershëm, të kesh cipë, të kesh guxim, të kesh kurajë, të përballësh, të shohësh në sy, të mos fshihesh pas frustrimit dhe të mos fshihesh pas veshit..., po, e kundërta duartrokitet, sepse publikut i pëlqen loja e gaztorit, i pëlqen loja e palaços, i pëlqen loja e harbutit.

Unë jam në politikë që prej vitit 2009 dhe në politikë kam ardhur me vullnetin tim të lirë, nuk më kanë sjellë as lojërat, as lidhjet, as ndonjë karrierë e hershme e zhvilluar në ndonjë bodrum selie partie. Po, kam qenë prokurore dhe jam e nderuar, sepse në këtë parlament, në 30 vjet, vetëm 3 njerëz kanë ardhur nga Shkolla e Magjistraturës. Në fund të ditës, jam njeri i arsyeshëm dhe formimin dhe arsyen time nuk i nëpërkëmb dhe nuk i ndërroj me bindjen time të brendshme.

Unë kam votuar që të lejohet prokuroria që të vendosë masën e arrestit me burg për Arben Ahmetajn, dhe këtë gjë nuk e kam bërë sepse kështu ka urdhëruar partia ime, këtë gjë e kam bërë

sepse kam bindje, dhe bindja ime buron nga formimi im, por kur dëgjoj këtu të thuhet: “T’ju vijë turp atyre që ishin në komisionin hetimor”, kjo është skandaloze! Nëse nuk do të ishim ne në komisionin hetimor, zonjë, ti nuk do të kishe mundësi ta drejtoje atë komision hetimor, nuk do të kishe mundësi të lexoje një raport!

Edhe sot që ishte dita t’i falënderoje kolegët e tu, të falënderoje zotin Spaho, fjala vjen, të falënderoje zotin Këlliçi, zotin Boçi, nuk e bëre, sepse kolegët e tu nuk e votuan raportin tënd, sepse këtu logjika e kundërshtarit nuk funksionon sipas përballjes me të vërtetën, por funksionon sipas përballjes me gënjeshtren; këtu logjika e kundërshtarit nuk funksionon sipas standardit të njerëzillëkut dhe qytetarisë, por funksionon sipas standardit të harbutit.

Unë, kolegë, ju ftoj të gjithëve që, kur të votoni për të hequr origjinalët, të jeni të lumtur se keni hequr edhe kopjet. Dhe e dini çfarë kopjesh keni hequr? Keni hequr kopjet e harbutëve, të cilët nuk meritojnë as të dëgjohen.

Poshtë harbutët, bashkë me spiunët!